



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 209 Prot.

Pogradec, më 05.06.2026

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë Projekt Vendimin dhe relacionin shoqërues:

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 46, DATE 29.05.2025 “PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADECIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”

Me respekt,

KRYETARI
Ili XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 4 (katër)

Nr. i i dok Shoqëruese 1 (një)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, DATË ____ / ____ /2026

PËR

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 46, DATE 29.05.2025 “PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADECIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 55 pikat 2 dhe 6, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, I ndryshuar, Ligjit nr. 156, datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, në nenet 12, 41 dhe 85 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Vendimi nr. 776, date 19.02.2025 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”, “Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar, VKB-së nr. 24, datë 27.03.2025 “Për miratimin e taveve përgatitore buxhetore për Vitet 2026-2028”, VKB-së nr. 141, datë 27.12.2024 “Për miratimin dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec për Vitin 2025”, VKB-së nr. 46, date 29.05.2025, si dhe referuar Kërkesave me nr. 1077 Prot, datë 05.03.2026 dhe nr. 1077/1 prot, date 04.05.2026, me lëndë “Kërkesë për rritje fondi” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,



VENDOSI:

1. Të miratojë kompensimin e pagës minimale Kontraktorit të shërbimit të pastrimit, për Marrëveshjen Kuadër me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative” nga muaji Janar 2026 e në vijimësi, sipas VKM-së nr. 776, date 19.02.2025 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”.
2. Fondi financiar për kryerjen e shërbimit mbetet i njëjtë, sa oferta financiare e kontraktorit mbi bazën e së cilës është nënshkruar marrëveshja kuadër, në vlerën prej 515 900 555, 62 (pesëqind e pesëmbëdhjetë million e nëntëqind mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë me tvsh.
3. Me akordimin e kompesimit të pagës minimale të kontraktorit, afati i marrëveshjes kuadër do të ndryshojë nga 48 muaj në 46 muaj, pasi me shtimin e fondeve për kompensim të pagës minimale brënda vlerës totale të përgjithshme, ulet afati kohor i shtrirjes së kësaj marrëveshje.
4. Fondi i përlogaritur për kompensimin e pagës minimale për vitin 2026 do t'i akordohet kontraktorit me nënshkrimin e minikontratës së radhës (korrik- dhjetor 2026).
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Pogradec, Drejtorja e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i tokës bujqësore në Njësiti Administrative dhe Shërbimeve, Drejtorja e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Prokurimeve pranë Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë sipas përcaktimeve pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar!

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 2404/Prot.
14

Pogradec, më 05.06.2026

RELACION

PËR

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 46, DATE 29.05.2025“PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADECIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, në mbështetje të nenit 23, pika 10 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ku cilësohet se: *Bashkitë ndër të tjera janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake”.*

Në 22.09.2025, Bashkia Pogradec ka nënshkruar Marrqveshjen Kuadër, me afat 48 Muaj, me vlerë të pritshme 515 900 555, 62 (pesëqind e pesëmbëdhjetë million e nëntëqind mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) leke me tvsh, per qytetin Pogradec dhe Njësitë Administrative.

Bazuar në Kërkesat me nr. 1077 Prot, datë 05.03.2026 dhe nr. 1077/1 prot, date 04.05.2026, me lëndë “Kërkesë për rritje fondi” nga Kontraktori i shërbimit, Titullari i Bashkisë Pogradec ka ngritur një Grup Pune për “Shqyrtim të Kërkesave të Kontraktorit”, me qëllim hartimin e një analize të detajuar nëse kontraktori legjitimohet në kërkesat e tij.

Grupi i punës pasi ka bërë analizën duke u mbështetur në tre këndvështrime:

-Së pari, a ka mbështetje ligjore një pretendim i tillë nga Kontraktori?

-Së dyti, nëse po cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e Autoritetit Kontraktor (Bashkisë) ose kostoja e ndikimit financiar.Dhe së fundmi, përfundimi i këtij argumentimi nga grupi i punës , me hapat konkretë që duhet të merren.



Nisur nga sa më sipër, grupi i punës ka hartuar një relacion me anë të të cilit ka shpjeguar me detaje se si ndikon kjo rritje page në shërbimin e pastrimit.

Për shkak të rritjes së pagës minimale në shkallë vendi, sidomos në objektin e shërbimit të pastrimit, i cili është shërbim me **intensitet të lartë të fuqisë punëtore**, ku kostoja e pagave dhe kontributeve përbën pjesën kryesore të çmimit dhe rritja e pagës pagës minimale ndikon drejtpërdrejt në **rritjen e kostos së zbatimit të kontratës**, kjo do të krijonte një **çekuilibër ekonomik** midis detyrimeve kontraktore dhe çmimit fillestar.

Kështu hyrja në fuqi e aktit normativ për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi përbën një ndërhyrje të detyrueshme ligjore, e cila ndikon drejtpërdrejt në koston e zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit, si një shërbim me intensitet të lartë të fuqisë punëtore.

Po ashtu referuar nenit 24/7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, citojmë: *“Ofertat ekonomike të dhëna nga ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t’i nënshtrohen asnjë ndryshimi.*

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës”.

Pra, çmimi i kontratës është i fiksuar gjatë ekzekutimit të saj (marrëveshjes kudër). Megjithatë, i njëjti nen parashikon përjashtimin në rastet kur, pas lidhjes së kontratës, hyjnë në fuqi akte ligjore ose nënligjore që ndikojnë në kushtet apo çmimin e saj.

Referuar edhe në nenin 34/9 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku citohet se: *“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti ose enti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës në përputhje me inflacionin e publikuar”.*

Gjithashtu mbwshtetur në nenin 19 “Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë”, tw kontratës së shërbimit të pastrimit ku thuhet se: *“Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës”.*

Pra , për sa më sipër vlerësohet se rishikimi i çmimit është i ligjshëm dhe i justifikuar, duke u kufizuar vetëm në masën e ndikimit real të ndryshimit ligjor, pa ndryshuar natyrën dhe objektin e kontratës.



Duke iu përmbajtur marrëveshjes sonë kudër, e cila ka të theksuar faktin që çmimet mbeten të pandryshuara si dhe nuk ka të parashikuar një klauzolë për rishikimin e vlerës në përputhje me inflacionin e publikuar arrijmë në përfundimin se:

Pra rregulli kryesor është: çmimi është i fiksuar (neni 24/7 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021).

Ndërsa, përjashtimi i cili është thelbi i këtij relacioni është fakti që i njëjti nen lejon rregullim kur pas nënshkrimit të kontratës hyn në fuqi një akt ligjor/nënligjor që ndikon çmimin, në masën e ndikimit real.

Pra, edhe pa klauzolë në marrëveshjen kuadër, **vetë ligji e hap rrugën** për rishikim të vlerës totale të kontratës, për shkak të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, që bëjnë të detyrueshme rrutjen e pagës minimale.

- Pasi dalim në konkluzionin që përputhen kushtet ligjore për kompesimin e pagës minimale, grupi i punës analizon **avantazhet dhe disavantazhet e Autoritetit Kontraktor (Bashkisë) ose kostoja e ndikimit financiar.**

Analiza financiare (strukturë kostoje, edhe nëse nuk është në preventiv) e fuqisë punëtore llogaritet sipas kontratave të punës dhe listës së pagesave. Me anë të kësaj përllogaritjeje shihet sa ndikon rritja e pagës minimale në total.

Me pak fjalë grupi i punës ka "rikrijuar" strukturën e kostos me prova të tilla si: numri i punonjësve të angazhuar ;- paga para dhe pas rritjes ;- kontributet shoqërore; -orët e punës sipas kontratës. Përllogaritja e koston bashkëngjitur.

Me mbarimin e kësaj analize, duhet të kemi parasysh se disavantazhi me i madh i Bashkisë Pogradec, ne rast mos kompensimi financiar, do te jete ndërprerja e kontratës së shërbimit të pastrimit të qytetit dhe njësisve administrative nga kontraktori, duke krijuar kaos dhe një kosto shtesë për bashkinë, në një kohë aspak të volitshme për të (sezoni turistik).

Gjithashtu theksojmë faktin se, në rast se bashkia do të ishte përpara një procedure të re prokurimi për këtë shërbim, atëherë llogaritja e koston së këtij shërbimi do të kryhej sipas kushteve aktuale dhe sipas legjislacionit aktual ne fuqi të pagës minimale. Pra, në thelb do të kishim një rritje të shtuar të koston së shërbimit të pastrimit dhe jo vetëm.

-Në lidhje me hapat konkretë që duhet të merren për likuidimin e kompensimit të pagës minimale, duke qenë se çmimet janë fikse , të pandryshuara gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, bazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit publik, atëherë grupi i punës del në konkluzionin se kontraktori në secilën faturë mujore do të pasqyrojë edhe zërin e kompensimit të pagës përvec zërave të shërbimeve që do të kryhen.



Bashkëngjitur faturës dhe situacionit të muajit koherent duhet të jenë edhe listëpagesat e punonjësve të kontraktorit për të vërtetuar pagesën e punonjësi me kohë të plotë dhe pagë minimale ,sipas VKM-së nr. 776, date 19.02.2025 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”.

Për sa më sipër, kërkojmë:1- Miratimin e kompensimit të pagës minimale për Kontraktorin e shërbimit të pastrimit, për Marrëveshjen Kuadër me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative”, nga muaji Janar 2026 e në vijimësi, sipas VKM-së nr. 776, date 19.02.2025 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”.

2-Fondi financiar për kryerjen e shërbimit mbetet i njëjtë, sa oferta financiare e kontraktorit mbi bazën e së cilës është nënshkruar marrëveshja kuadër, në vlerën prej 515 900 555, 62 (pesëqind e pesëmbëdhjetë million e nëntëqind mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë me tvsh.

3- Me akordimin e kompensimit të pagës minimale të kontraktorit, afati i marrëveshjes kuadër do të ndryshojë nga 48 muaj në 46 muaj, pasi me shtimin e fondeve për kompensim të pagës minimale brënda vlerës totale të përgjithshme, ulet afati kohor i shtrirjes së kësaj marrëveshje.

4- Fondi i përlogaritur për kompensimin e pagës minimale për vitin 2026 do t'i akordohet kontraktorit me nënshkrimin e minikontratës së radhës (korrik- dhjetor 2026).

Bashkëngjitur materiale:

1.Përlogaritja e kostos së shtuar të shërbimit të pastrimit me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.

Duke pasur besim të plotë, ju ftojmë të miratoni projekt vendimin e paraqitur.

Ju faleminderit!

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 2409 Prot
4

Pogradec, më 05.06.2026

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 46, DATE 29.05.2025 “PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADECIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar: “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në Ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcaktohet: “Akt me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në Nenin 8 shkronja “a” përcakton se : “është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.”



Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

“**Akt normativ nënligjor**” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1, shkronja “a” e Kodit të Proçedurës Administrative jep këtë perkufizim për “aktin administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një akt administrativ me karakter normativ, i cili plotëson elementet e përcaktuar në Nenin 3, pika 2 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij, si dhe me miratimin e tij do të ketë një ndikim të rëndësishëm për komunitetin dhe mjedisin . Ky projekt-vendim i drejtohet kontraktorit të shërbimit të pastrimit , duke mundësuar vazhdimin e kontratës të pastrimit , duke kompesuar efektin financiar të rritjes së pages minimale , pa rritur fondin total të miratuar.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas legjislacionit në fuqi.

Konceptoi: N. NAUN

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI

Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njesive Administrative”



SHPENZIME PER PAGA DHE SIGURIME SHOQERORE

EMERTIMI	Nr Personel	Ore Pune/dite	Paga Baze	Sigurime Shoqerore	Totali lek/vit	Leke/dite
Puntore	39	6	50000	16.70%	27307800	74815.89
Puntore	39	6	40000	16.70%	21846240	59852.71
DIFERENCA					5461560	14963.18

KESTI PER NJE MUAJ ESHT:

455130 LEK DHE DO HYJE NE FUQI NGA MUAJ JANAR 2026 E NE VAZHDI

SIPAS LLOGARITJES NE FILLIM AFATI I KONTRATES ISHTE 48 MUAJ ME NJE VLERE 523 598 619 LEKE ME TVSH
ME NJE KEST MUJOR 523 598 619 / 48 = 10 908 304 LEKE NE MUAJ

VLERA TOTALE E MARREVESHJES KUADER 48 MUAJ:

429 917 129

8 956 607

LEKE NE MUAJ (48 MUAJ)

FAKTI I MUAJVE Tetor-Nentor-Dhjetor QE NUK KEMI PASUR NDRYSHIM TE PAGES ESHTE 26869821

NDERSA NGA JANARI KEMI NDRYSHIM TE KESTIT MUJOR 8956607 LEK QE KA QENE. DO TI SHTOHEN EDHE KOMPENSIMI I PAGES MINIMALE
PER 39 PUNONJES

TE CILET NE KOSTON FILLESTARE JANE PERLLOGARITUR ME PAGA MINIMALE 40000 LEK + SIGURIMET SHOQERORE/SHENDETESORE
NDRYSHIMI NE KOSTON MUJORE: ISHTE 10747928.24 LEK ME TVSH. BËHET 89566074 + 455130 =9411737 LEKE NE MUAJ

Duke mbajtur ne konsiderate vleren totale te Marrvveshjes kuader, Grupi I Punes ka zbritur diferencat faktike te Muajve Tetor-Nentor- Dhjetor te cilat jane te likuiduara dhe mbehet vlera prej 403047308 leke me tvsh

Nga kjo vlere do te perpiestojme kesin mujor qe perbehet nga sherbimet e planifikuara per tu kryer dhe kompensimin e pages minimale dhe na rezulton vlera prej 9411737 leke ne muaj. Si perfundim, nga perlllogaritja totale na rezulton se perituhda e mbetur e Marrvveshjes Kuader do te shkoje ne 46 Muaj nga 48 te planifikuara.

GRUPI I PUNËS:

Dritan BABASULLI
Klajdi BIZGJONI
Violeta ÇEKANI